

LIGJ
Nr. 9607, datë 11.9.2006

PËR KËSHILLIN KONSULTATIV TË BIZNESIT

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi

Këshilli Konsultativ i Biznesit (KKB) është organ këshillimor i Këshillit të Ministrave për zhvillimin e politikave ekonomike dhe për përmirësimin e kuadrit ligjor përkatës.

Neni 2
Objekti i veprimtarisë

1. Objekti i veprimtarisë së Këshillit Konsultativ të Biznesit është përgatitja e rekomandimeve për Këshillin e Ministrave dhe Kuvendin, nëpërmjet dialogut shtet-privat në:

a) procesin e hartimit të strategjive dhe të programeve qeveritare të zhvillimit të ekonomisë;

b) procesin e përgatitjes së Buxhetit të Shtetit dhe të paketave fiskale;

c) politikat e privatizimit;

ç) politikat e prokurimit publik;

d) politikat e nxitjes së investimeve;

dh) politikat e zhvillimit të tregtisë dhe të biznesit;

e) politikat e konkurrencës, mbikëqyrjes së tregut dhe mbrojtjes së konsumatorëve.

2. KKB-ja ia dërgon përfundimet dhe rekomandimet e saj Këshillit të Ministrave dhe Kuvendit. Projektaktet e përgatitura nga institucionet qendrore të administratës, sipas objektivave të përcaktuar në pikën 1 të këtij neni, i dërgohen për mendim KKB-së.

Neni 3
Burimet e financimit

Burimet e financimit të KKB-së janë:

1. Buxheti i Shtetit.

2. Burime të tjera të ligjshme.

KREU II
PËRBËRJA, EMËRIMI I ANËTARËVE DHE FUNKSIONIMI I KËSHILLIT KONSULTATIV
TË BIZNESIT

Neni 4

Përbërja e Këshillit Konsultativ të Biznesit

1. Këshilli Konsultativ i Biznesit kryesohet nga ministri përgjegjës për ekonominë dhe ka në përbërje përfaqësues nga:

- a) Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë;
- b) shoqatat e biznesit, vendase dhe të huaja;
- c) shoqëria civile në fushën e biznesit;
- ç) institucionet shtetërore;
- d) organizmat e pushtetit vendor.

2. Këshilli Konsultativ i Biznesit përbëhet nga jo më pak se 15 dhe jo më shumë se 20 anëtarë, ku shumica i përket përfaqësuesve të biznesit. Kryetari e përfaqëson këtë Këshill në marrëdhënie me të tretët. KKB-ja vepron nëpërmjet komisioneve të këshillimit dhe sekretariatit teknik.

Neni 5

Mënyra e funksionimit

Mënyra e funksionimit dhe e përdorimit të fondeve financiare të KKB-së, komisioneve të këshillimit dhe sekretariatit teknik përcaktohen në rregulloren “Për funksionimin e Këshillit Konsultativ të Biznesit”.

Rregullorja e funksionimit të Këshillit Konsultativ të Biznesit miratohet nga ministri përgjegjës për ekonominë.

Neni 6

Emërimi i anëtarëve të Këshillit Konsultativ të Biznesit dhe kohëzgjatja e mandatit të tyre

Anëtarët e Këshillit Konsultativ të Biznesit emërohen nga ministri përgjegjës për ekonominë për një periudhë 2-vjeçare me të drejtë rizgjedhjeje një herë, ndër tre kandidaturat e paraqitura nga institucioni përkatës, sipas nenit 4 pika 1 të këtij ligji.

Kriteret dhe procedurat e caktimit përcaktohen në rregulloren e funksionimit të këtij Këshilli.

Neni 7

Sekretariati teknik

Veprimtaria administrative e Këshillit Konsultativ të Biznesit realizohet nga sekretariati teknik, i cili emërohet nga Kryetari i këtij Këshilli.

Neni 8

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.5057, datë 4.10.2006 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu**